

VENDIM
Nr.870, datë 18.6.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.7.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe të Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjala e parë e pikës 4 të vendimit nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Masa e përfitimit për shkak të verbërisë është 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që përfitojnë nga shteti”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë, përballohen nga fondet e buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli I, artikulli 606, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha